

## I. THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Në kuadër të projektit STAR3 “Mbështetje dhe Avancimi i Reformave të Qeverisjes Vendore”, Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, në cilësinë e Partnerit po zbaton komponentin “Promovimi i Konsultimit Publik dhe Pjesëmarrjes në Nivel Vendor”. Përmes këtij komponenti do të asistohen 7 bashki për zhvilluar një praktikë të qëndrueshme të konsultimit publik, konform parashikimeve ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Planifikimi i detajuar dhe përdorimi i metodave inovatore për një angazhim domethënës në konsultime, duke përfshirë teknologjinë e informacioni do të jenë objektivi kryesor i kësaj asistence.

**Asistenca do të ketë në fokusin e saj degën ekzekutive të bashkisë, si pjesë integrale e ciklit vendimarrës dhe politikbërjes në nivel të qeverisjes vendore.**

Shtatë (7) bashki do të përzgjidhen për pilotimin e këtij komponenti në bazë të kriterëve të paracaktuara. STAR 3 synon krijimin e një praktike të mirë dhe të replikueshme edhe në bashkitë e tjera. Krijimi i një standarti të unifikuar për proceset e konsultimit në nivel vendor, me fokus degën ekzekutive si iniciuese e ciklit vendimarrës dhe përgjegjëse për implementimin e tij, është objektivi i kësaj asistence teknike.

Identifikimi dhe përzgjedhja e 7 bashkive do të bëhet nëpërmjet një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës. Shprehja e interesit nga ana e bashkive për t’u bërë pjesë e këtij programi asistence i paraprin vlerësimin të kriterëve. INFOÇIP do të lehtësojë dhe asistojë me kapacitete teknike procesin nëpër të cilin do të kalojnë bashkitë e përzgjedhura.

Për bashkitë e seleksionuara do të hartohen një raport vlerësimi mbi bazën e të cilit do të përcaktohen termat konkretë të asistencë. Për secilën nga bashkitë e përzgjedhura, INFOÇIP do të asistojë hartimin e planeve vjetore sipas një standarti të avancuar i cili mban parasysh funksionet e bashkisë si dhe detyrimet ligjore për organizimin e konsultimeve sipas kërkesave ligjore në fuqi.

- Për secilën nga bashkitë e përzgjedhura, STAR3/INFOÇIP do të ofrojë mjete për të implementuar procesin konsultativ si dhe për të rritur pozitivisht impaktin e tij në ciklin vendimarrës.
- Planet vjetore të konsultimit publik do të modelohen dhe implementohen përmes asistencës teknike që STAR 3/INFOÇIP do të vërë në zbatim në kuadër të këtij komponenti.
- Në bashkitë që do të bëhen pjesë e tij programi asistence, do të zhvillohen 14 seanca konsultimesh publike 92 për secilën bashki përftuese).
- STAR3/INFOÇIP do të asistojë bashkitë për hartimin e raporteve vjetore për konsultimin publik dhe dokumentimin e plotë të praktikës konsultative brenda vitit 2022.
- Stafet përgjegjëse të bashkive që do përzgjidhen për këtë program do të trajnohen si dhe do të pajisen me setin e plotë templateve për planifikimin e konsultimeve si dhe raportimin e tyre periodik (gjashtë-mujor dhe vjetor).
- STAR3/ INFOÇIP do të asistojë bashkitë përftuese të diseminojnë praktikatat e mira edhe në bashkitë e tjera duke krijuar një mjedis të frytshëm ndërveptimi me synim pasurimin e praktikës.

## II. KONTEKSTI

Konsultimi publik dhe pjesëmarrja në vendimmarrje janë gurë themeli për qevrirsjen e mire dhe demokracinë në nivel vendor. Bashkitë e Shqipërisë kanë shënuar përparim në fushën e të drejtës për informim si dhe në garantimin e një pjesëmarrje më të zgjeruar të qytetarëve në proceset vendimarrëse.

Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve në fushën e legjislacionit dhe ndërtimit të disa praktikave pozitive, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje dhe konsultime me komunitetet lokale mbeten sërish në nivele të ulëta. Kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm për të siguruar konsultime domethënëse që të sigurojnë konsensus më të gjerë që në fazën e hartimit të politikave.

Për shkak të zgjerimit që pësuan bashkitë si rezultat i Reformës Administrative Territoriale, pjesëmarrja sa më domethënëse e komuniteteve, grupeve të interesit dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor përfaqëson një sfidë. Me zgjerimin e territoreve juridiksionale të bashkive në qytete dhe në fshat, qeverisja me pjesëmarrjen e publikut ka nevojë të mbështetet. Rikonceptimi i mjeteve që sigurojnë këtë mbështetje është interes parësor në kuadër të këtij komponenti. Baza ligjore që normon njoftimin dhe konsultimin publik në nivel vendor është zgjeruar, por praktika e deritanishme sugjeron se ka ende shumë rrugë për të bërë në funksion të përfshirjes reale të interesave të publikut në vendimmarrje.

Vlerësimet e realizuara në kuadër të Projektit STAR 2, nxorrën në pah disa shqetësime serioze, si nga publiku ashtu edhe nga pushteti vendor sa i takon mungesës së aktivizimit, angazhimit dhe ndikimit të shoqërisë civile në vendimmarrje si dhe përfshirjen efektive të komuniteteve. Mungesa e platformave të besueshme të konsultimit ka ndikuar në distancimin e pushtetit vendor nga qytetari dhe anasjelltas.

Besimi i publikut në qeverisjen vendore në disa raste ka shënuar rënie. Mungesa e besimit sjell si pasojë dobësimin e hallkave të ndërveprimit me komunitetin, duke krijuar deficit demokratik. Ajo që Bashkitë ofrojnë sot, në përgjigje të kërkesave ligjore për të informuar, ndërvepruar dhe angazhuar qytetarët, është ende larg të qenit kuptimplotë dhe domethënëse në shumicën e rasteve.

Projekti STAR3 ka përfshirë në fushën e veprimit të tij adresimin e problematikës së konstatuar. Brenda vitit 2022 synohet krijimi i praktikave të mira në shtatë bashki që do të përzgjidhen për këtë qëllim. STAR3 zbatohet nga UNDP në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe pushtetin vendor. Projekti financohet nga BE, qeveritë e Suedisë dhe Zvicrës, UNDP dhe Qeveria Shqiptare.

## III. SI TË APLIKONI

Bashkitë e interesuara duhet të dërgojnë një Letër Motivimi të firmosur dhe vulosur nga Kryetari/Kryetarja e Bashkisë në adresën [gendra@infocip.org](mailto:gendra@infocip.org), me titull “Shprehje Interesi për Programin e Konsultimit Publik”. Afati i dorëzimit: **2 Mars 2022, ditë e martë, ora 23:59.**

#### IV. KRITERET PËR APLIKIM

Në këtë seksion renditen kriteret që duhen përmbushur nga Bashkitë që do të shprehin interesin e tyre për t'u bërë pjesë e këtij Programi. Në terma të shpërndarjes gjeografike, STAR 3 / INFOCIP do të disponojnë rezervën të diversifikojnë bashkitë përftuese sa i takon vendodhjes gjeografike dhe tipologjisë Administrativo-Territoriale. Gjatë shqyrtimit të aplikimit do të synohet përfshirja e bashkive përftuese në nivel qendër Qarku, bashkive të mesme (ish-qendër rrethi) dhe bashkive të vogla, sipas kategorizimit ligjor në fuqi.

##### **Kritere mbi kapacitetet/burimet njerëzore**

1. Të ketë koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik
2. Të ketë koordinator për të drejtën e informimit
3. Të ketë staf IT si pjesë e organikës së Bashkisë
4. Të paktën dy grupe interesi të identifikueshme që janë aktive në ndërveprimin me bashkinë
5. Të paktën dy organizata lokale në sektorin e shoqërisë civile që kanë ndërveprim me bashkinë

##### **Kritere teknike dhe infrastrukurore**

1. Të kenë një faqe online (website) funksionale dhe që përditësohet rregullisht
2. Të kenë llogari aktive në YouTube, FB dhe/ose platforma të tjera sociale
3. E preferueshme: Të kenë kapacitete teknike për implementimin e procesit të konsultimit publik (kamera, mikrofonë, etj.)
4. Të kenë sallë/mjedise fizike që mund të akomodojnë konsultime me pjesëmarrje.
5. Të kenë kapacitete dokumentuese (të instaluar ose të lëvizshme) për procesin e konsultimit publik (rrjet kompiuterik, hard-disc, pult ose regji qendrore, etj)

##### **Kritere të përvojës**

1. Të ketë përvojë të demonstrueshme në ndërveprimin me komunitetin dhe grupet e interesit.
2. Të ketë përvojë në partneritetin me organizatat e shoqërisë civile në nivel vendor.
3. Të ketë stafe që mund të angazhohen në implementimin e komponentëve të asistencës teknike që do ofrojë STAR3/INFOCIP
4. Të ketë staf të kualifikuar për hartimin e kornizës së bashkëpunimit sipas specifikave të bashkisë në të cilën implementohet komponenti
5. Të kenë përvojë në ndërveprimin me partnerët në fushën e programeve që promovojnë pjesëmarrjen e publikut në politik-bërjen vendore.

##### **Kritere formale të angazhimit**

1. Të garantojnë vullnetin institucional për të marrë pjesë në programin e asistencës si dhe për respektimin e procedurave ligjërish të detyrueshme në lidhje me konsultimin publik në RSH.
2. Të dorëzojë zyrtarisht një "Letër Shprehje Interesi" për të qenë pjesë e këtij komponenti.
3. Të angazhohen përmes një Memorandumi Bashkëpunimi për ngritjen e kapaciteteve që mundësojnë një konsultim publik domethënës në nivel të qeverisjes vendore.
4. Të miratojnë planin vjetor të konsultimit publik që do hartohet si pasojë e këtij angazhimi
5. Të vendoset në faqen zyrtare të internetit listën e partnerëve në zhvillimin e konsultimeve publike.